

Titulli i lëndës: PRODUKSION & POSTPRODUKSION

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Produksion & Postproduksion
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Z
Viti i studimeve:	2024-2025
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	E hënë, 11:00, Salla 51
Mësimdhënësi:	Prof. Asoc. Dr. Arben Fetoshi
Të dhënat kontaktuese:	arben.fetoshi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda “Produksion & Postproduksion” ofron njohuri teorike dhe praktike për procesin e prodhimit në mediat transmetuese. Përmbajtja e kësaj lënde bazohet kryesisht në literaturën e huaj, me qëllim të përvetësimit të parimeve, standardeve dhe praktikave më të mira për Produksionin dhe Postproduksionin në media. Duke shqyrtuar konceptet themelore, elementet dhe procesin e prodhimit të përmbajtjeve mediale që nga planifikimi deri te transmetimi në radio dhe televizion, studentët do të përgatiten për punë cilësore të mbështetur në standardet më të larta profesionale dhe etike. Temat janë përcaktuar në funksion të përgatitjes teorike dhe praktike, duke fokusuar rëndësinë e ekuilibrit ndërmjet komponentëve editorial, teknik dhe normativ.
Qëllimet e lëndës:	Nëpërmjet ligjëratave, diskutimeve në klasë dhe pjesës së ushtrimeve, studentët do të aftësohen për procesin e prodhimit medial, parimet e punës dhe rëndësinë e gjykimit editorial. Lënda synon t’i njoftojë studentët me fazat e prodhimit, praktikat më të mira bashkëkohore dhe mënyrat e ndërtimit të rrëfimit, duke u bazuar në standardet etike, interesin publik dhe ndikimin që produkti mund të ushtrojë në shoqëri apo te individët e përfshirë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:

	- Identifikojnë dhe shpjegojnë konceptet dhe parimet kryesore të Produksionit medial;
	- Njohin dhe aplikojnë procesin e prodhimit në medie, bazuar në raportin me audiencën;
	- Analizojnë, vlerësojnë dhe krahasojnë forma të ndryshme të produktit medial.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	2	1	2
Konsultime me mësimdhënësin	30 min.	15	7.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	10	2	20
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin final	4	1	4
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
Total			126.5

Metodat e mësimdhënies:

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë të formulës së mëposhtme:

1. Pjesëmarrja aktive	10 %
2. Ushtrime (detyrat)	20 %
3. Kolofiumi	20 %
4. Projekti (Produkti medial)	30 %
5. Provimit përfundimtar	20 %
TOTALI:	100 %

	Pjesëmarrja nuk nënkupton vetëm vijueshmërinë, studentët do të vlerësohen në bazë të cilësisë së komenteve, vëmendjes, qëndrimit dhe sjelljes në klasë.
Literatura primare:	1. Neil Everton, <i>Përgatitja e lajmit televiziv</i>, IREX, Prishtinë 2. Andrew Boyd, <i>Broadcast Journalism</i>, pdf
Literatura shtesë:	1. Gerald Millerson & Jim Owens, <i>Video Production Handbook</i>, Fourth Edition, ELSEVIER 2. Philip Patterson & Lee Wilkins. (2009). <i>Etika në Media</i>, Çështje dhe raste, UFO Press, Tiranë 3. Audiovisual Media Services Directive, https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32010L0013&from=EN 4. Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Programet e Radiotelevizionit të Kosovës, http://www.rtklive.com/pages/files/standardet_profesionale.pdf

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje në Produksion & Postproduksion (<i>Faktorët ndikues</i>)
Java 2:	Paraproduksioni (<i>Planifikimi dhe teksti</i>)
Java 3:	Elementet e Produksionit në Radio
Java 4:	Elementët e Produksionit në Televizion
Java 5:	Parimet themelore të Postproduksionit
Java 6:	Vlerat editoriale dhe etike (<i>Kodi i Sjelljes i BBC-së dhe Standardet Profesionale të RTK-së</i>)
Java 7:	Testi Intermediar
Java 8:	Modelet e organizimit të mediave (<i>Redaksia</i>)
Java 9:	Roli i Producentit (<i>Rrëfimi, verifikimi, xhirimi, montimi</i>) (<i>Bashkëbisedim me një producent të radios ose televizionit</i>)

Java 10:	• Vizitë studimore në Radio / TV / Portal
Java 11:	• Përcaktimi për produktin medial (<i>Planifikimi, Organizimi, Realizimi dhe Vlerësimi</i>)
Java 12:	• Direktiva e BE-së për Shërbimet Mediale Audiovizuale (<i>Mbrojtja e grupeve të “brishta” si fëmijët, personat me nevoja të veçanta, etj.</i>)
Java 13:	• Produksioni Multimedial
Java 14:	• Seminar vlerësues (<i>produkti i realizuar për radio ose televizion</i>)
Java 15:	• Diskutim përmbledhës për lëndën

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën në heshtje për të marrë shënime; aktivitete të tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi. Nga të gjithë pritet të jenë të sjellshëm dhe të respektueshëm ndaj të tjerëve gjatë diskutimeve, dhe nuk bënë të përdorët gjuhë e pahijshme. Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe janë pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit.